

VENDIM
Nr.631, datë 24.12.1999

**PËR AKORDIMIN E FONDEVE BUXHETORE PËR SKEMËN E TË PASTREHËVE TË
ADMINISTRATËS SË LARTË SHTETËRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8095, datë 21.3.1996, “Për shërbimin civil në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministisë së Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave të përdoren 160 milionë lekë, për skemën e strehimit të administratës shtetërore.

2.Kriteret, termat dhe procedurat e përfitimit të kredisë të jenë sipas përcaktimit të bërë me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.102, datë 5.3.1999, “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe të nënpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore”.

3.Kjo shumë të transferohet në Bankën e Kursimeve, e cila ngarkohet për zbatimin e rregullave, që do të caktohen për këtë qëllim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta